

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pse Rinasi po konkurron aeroportet e Rumanisë dhe Bullgarisë?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/pse-rinasi-po-konkurron-aeroportet-e-rumanise-dhe-bullgarise-i588451
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 06:07:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 06:02:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e5bd37dd57d3dd0a718fbc26083bee01559fa1940fefbee5b77039cf9d4fb225
TEKSTI	3c270aef007010476583a4e086a619ef101f4b2bf714a53ee07bba07ed69cf6b
PAMJA	a36acf67ffbf567309660c65194fd8b6059d2ea90c2b548048ca266af03569

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2dd18e2eb5b0ac6dd558236f11982652202d512b73db1e940f8488565190a49d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	df7a3e632afe7e8acb9ac556f323199c5ae38613c8b46aabf6598ebdbd0b152a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2dd18e2eb5b0ac6dd558236f11982652202d512b73db1e940f8488565190a49d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

Pse Rinasi po konkurren aeroportet e Rumanisë dhe Bullgarisë? SHBA po planifikon hyrjen ushtarake në Kube m Aksidenti i rende ne Fushe-Kruje, nderron jete 19-vjeçar fundit

Pse Rinasi po konkurren aeroportet e Rumanisë dhe Bullgarisë?



26 Shtator 2026, 08:02 Blog Nga Fatos Çoçoli

Gjatë 8 viteve të fundit (2019-2026), Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës është shndërruar në një nga treguesit më të dukshëm të ndryshimit ekonomik dhe social të Shqipërisë gjatë viteve të fundit. Rritja e fortë e numrit të pasagjerëve e ka pozicionuar Tiranën në krye të aeroporteve të rajonit për trafikun e udhëtarëve, duke e bërë aeroportin një pikë të rëndësishme lidhjeje të Shqipërisë me Evropën dhe tregjet ndërkombëtare.

Në dy vitet e fundit 2024-2025, Rinasi ka kaluar aeroportin kryesor të Serbisë Nikola Tesla, pra të një ekonomie tre herë më të madhe se e jona, me 8 dhe 19 përqind në vëllimin e pasagjerëve. Këtë vit po konkurren me aeroportet kryesore të Rumanisë dhe Bullgarisë.

Ky zhvillim nuk duhet parë vetëm si një statistikë e sektorit të transportit ajror. Numri i pasagjerëve që kalojnë përmes aeroportit është një tregues i drejtpërdrejtë i rritjes së lëvizshmërisë së shqiptarëve, zgjerimit të turizmit, shtimit të udhëtimeve të biznesit, rritjes së lidhjeve familjare me Diasporën dhe fuqizimit të lidhjes së ekonomisë shqiptare me botën.

Një ndryshim i dukshëm në ekonominë shqiptare

Vetëm pak vite më parë, më 2018, aeroporti i Tiranës kishte një volum shumë më të kufizuar udhëtarësh. Sot situata është transformuar ndjeshëm. Rritja e destinacioneve, hyrja e kompanive ajrore me kosto më të ulët, shtimi i frekuencave dhe zgjerimi i turizmit kanë bërë që aeroporti të funksionojë me një intensitet shumë më të lartë.

Të dhënat për vitet e fundit tregojnë një zgjerim të shpejtë të trafikut. Në vitin 2025, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës arriti rreth 11.6 milionë pasagjerë, një volum që e vendosi atë ndër aeroportet më të mëdha të Ballkanit për nga numri i udhëtarëve.

Kjo rritje është veçanërisht domethënëse, po të krahasohet me madhësinë e popullsisë së Shqipërisë. Një vend me rreth 2.4 milionë banorë po menaxhon një volum vjetor udhëtarësh disa herë më të madh se popullsia rezidente.

Kjo tregon se aeroporti nuk shërben vetëm për shqiptarët që udhëtojnë jashtë vendit. Një pjesë e konsiderueshme e trafikut lidhet me turizmin ndërkombëtar, Diasporën dhe Shqipërinë si destinacion udhëtimi.

Zgjerimi i trafikut ajror është i lidhur ngushtë me transformimin e turizmit shqiptar.

Rritja e numrit të turistëve të huaj ka krijuar një kërkesë të madhe për transport ajror. Në të njëjtën kohë, shtimi i fluturimeve dhe destinacioneve e ka bërë Shqipërinë më të aksesueshme për turistët evropianë.

Aeroporti si portë e ekonomisë shqiptare

Aeroporti i Tiranës po merr gjithnjë e më shumë karakterin e një infrastrukture strategjike ekonomike.

Një aeroport i madh nuk është vetëm vendi ku hipin dhe zbresin avionët. Ai krijon një ekosistem ekonomik që përfshin transportin, logjistikën, hotelerinë, tregtinë, shërbimet, mirëmbajtjen, sigurinë, teknologjinë dhe punësimin.

Rritja e fluksit të udhëtarëve rrit edhe kërkesën për investime të reja rreth aeroportit. Kjo mund të ndikojë në zhvillimin e zonave përreth, në ndërtimin e hoteleve, strukturave të shërbimit, qendrave logjistike dhe infrastrukturës rrugore.

Një prej ndryshimeve më të prekshme është edhe ndryshimi në mënyrën se si shqiptarët lidhen me Evropën dhe botën.

Sot udhëtimi drejt shumë qyteteve evropiane është më i shpejtë, më i shpeshtë dhe në shumë raste më i përballueshëm. Kjo ka ndikuar te studentët, bizneset,

emigrantët, familjet dhe turistët.

Për biznesin, lidhjet ajrore kanë një rëndësi të veçantë. Një investitor i huaj që mund të arrijë në Tiranë me një fluturim direkt nga një prej qendrave të mëdha evropiane e ka më të lehtë të krijojë dhe të menaxhojë marrëdhënie ekonomike në Shqipëri.

Pra, aeroporti nuk është vetëm një infrastrukturë transporti; ai është edhe një faktor konkurrues për ekonominë tonë.

Rritja e aeroportit është një nga ndryshimet që mund të perceptohen drejtpërdrejt nga qytetarët. Nuk është një tregues abstrakt makroekonomik. Ai shihet në numrin e destinacioneve, në fluksin e turistëve, në frekuencën e avionëve dhe në mundësinë për të udhëtuar më lehtë drejt vendeve të tjera.

Në këtë kuptim, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës është bërë një simbol i një Shqipërie më të lidhur me ekonominë evropiane dhe globale. Kemi më shumë njerëz që udhëtojnë, më shumë turistë që vijnë, më shumë lidhje biznesi, më shumë kontakte ndërkombëtare dhe një ekonomi më e integruar me pjesën tjetër të Evropës.

Prandaj dhe rritja e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës mund të konsiderohet një prej ndryshimeve më të prekshme të Shqipërisë së viteve të fundit.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

HOSTENI/ Sekretet tona, muhabete pazari

19:17 Blog / 9 komente

Çfarë fshihet në faqen 4 të mocionit të AfD-së

15:42 Blog / 2 komente

Sondazhi AIM: Tri çështje thelbësore të familjeve shqiptare

12:47 Blog



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.